

Trebinja voton më 24 tetor

Zgjedhjet për kryetarin e ri të komunës së Trebinjës do të zhvillohen më 24 tetor. Pritet një fitore e koalicionit në pushtet



Gjergji Buzo u arrestua dhe më pas u shkarkua nga kryeministri, nga posti i kryetarit të komunës, pas një denoncimi për korrupsion, si dhe kapje të tij në flagrancë, nga strukturat antikorrupsion të Pogradecit. Gjergji Buzo u zgjodh kryetar vetëm me 15 vota më shumë në zgjedhjet e 18 shkurtit 2006, përballë rivalit demokrat Genci Muço dhe e ushtroi këtë detyrë tre vjet, gjatë të cilës nuk mbahet mend për ndonjë gjë të madhe a mbajtje të ndonjë premtimi, por do të mbahet mend për aktin final, atë të arrestimit në flagrancë dhe, për fat ët keq, këtë njollë nuk do ta ketë vetëm ai, por edhe e gjithë Mokra e Trebinja, pasi do të kujtohet herë pas here si kryetari që u arrestua për 700 mijë lekë!

marrin pjesë në zgjedhje, pasi presin të hapen kutitë!!! Ka shumë mundësi që kryetari i ri të jetë nga LSI, ashtu siç përflitet sot. Vetëm në Pogradec LSI ka 2 komuna (Velçanin dhe Starovën) dhe mund të bëhen tre me kryetarin e ri. Më shumë se punë, zgjedhja e kryetarit të ri të Trebinjës do të jetë një test për zgjedhjet e 8 majit 2011. Koha e shkurtër që ka ai në dispozicion nuk do t'i lejojë atij të realizojë premtimet, por vetëm do të shtrojë shinat për mandatin tjetër 4-vjeçar, 2011-2015.

Komuna e Trebinjës ka 15 fshatra dhe mbi 15 mijë zgjedhës, por që nuk votojnë as gjysma e tyre. Gjithsesi i urojmë punë të mbarë kryetarit të ri që do vijë dhe të ketë fatin ta mbarojë në kohë dhe jo para afatit mandatin që i jep populli me votën e tij! Gjithashtu do të kërkojmë më shumë bashkëpunim me gazetën tonë dhe më shumë transparencë me median për gjithë punën dhe aktivitetin e tij!

Shuhet në SHBA Mirosh Markaj
 Shuhet në SHBA, në moshën 84-vjeçare dramaturgu, shkrimtari dhe intelektual i mirënjohur pogradecar Misto Marko, doktori i parë i Mokrës



Presidenti i Republikës Bamir Topi shpalli 24 tetorin, si ditën e zgjedhjeve për kryetarin e ri të komunës së Trebinjës. Siç dihet, zgjedhjet e parakohshme në këtë komunë bëhen pasi ish- kryetari i majtë



Nga jeta në SHBA e mokrarit Fahri Toska

Përsiatje etno-sociologjike
Rrëpirave të kujtesës kolektive
 Nga Bujar BALLIU


Ndërtimi i hidrocentraleve në Mokër



ME RASTIN E 6-MUJORIT TË NDARJES NGA JETA

Xha Rushani i Dunicës!

Nga Koço PIHONI



Krishterimi në zonën e Mokrës
 Nga Llazi TONA

ZEKMAN ÇUKU, NJË PARTIZAN TRIM, PO DHE NJË PUNTOR I PALODHUR NE DY SISTEMET

Bajram Rika, mjeku i parë stomatolog në Mokër

Falenderojmë nga zemra z. Bajram Rika për sponsorizimin e këtij numri të gazetës „Mokra“



TAKIM PUNE I DEGËS SË SHOQATËS "PELIONI" NË POGRADEC

Më datën 22 korrik 2010, në ambientet e mokrarit Nesti Maçolli në Pogradec, u bë një takim pune, me degën e shoqatës "Pelioni,, në këtë rreth. Në këtë takim ishte sekretari i shoqatës "Pelioni,, zoti Zenun Fero, dhe nënkryetari i shoqatës Istref Haxhillari. Në takim u diskutua puna tetëmujore e degës së shoqatës "Pelioni,, në Pogradec.

Puna e kësaj dege për këtë periudhë vlen për tu lavdëruar. Në vitin 2010 kjo degë organizoi më tetë maj 2010 në Pogradec 11 vjetorin e gazetës "Mokra,, duke u financuar nga antarët e shoqatës dhe biznesmenë te zonës. Aktiviteti i anëtarëve të shoqatës në gazetën "Mokra,, është në lartësinë maksimale vlen të përmendim anëtarët Isterf Haxhillari, Koço Pihoni, Bujar Balliu, Nesti Maçolli e Lllazar Tona. Shkrimet e tyre kanë qënë në nivelin më të mirë, dhe premtuan se do të rrisin më tej nivelin dhe sasinë e shkrimeve.

Lidhur me disa probleme që dolën gjatë takimit ishin: zgjerimi i mëtejshëm me anëtarë të rinj i shoqatës "Pelioni,, në Pogradec, në komunat Trebinjë, Velçan, Prrenjas, Rrajcë, Proptisht e tjerë. Një problem ishte edhe financimi i gazetës "Mokra,, si një udhë rrëfyese dhe program për vazhdimsinë e jetës normale të shoqatës. U kërkua që të aktivizohen më shumë gazetarë vullnetarë dhe rritjen e cilësisë informacionit apo problemit që trajtohet. Kjo kërkon të rritet më shumë në komuna dhe zona të largëta të krahinës Mokrës. Gazeta të propogandohet, shpërndahet duke u mbledhur të ardhurat e saj për të siguruar vazhdimësinë e saj. U diskutua për të organizuar më shumë takime dhe biseda me simpatizantë të shoqatës dhe dashamirës të gazetës "Mokra,, kudo që janë duke përhapur më tej zakonet dhe traditat e Mokrës.

Dega "Pelioni,, në Pogradec ka në programin e saj organizimin e një takimi në Komunën e Velçanit në vjeshtën e vitit

DREKË FESTIVE NË KOMUNËN E VELÇANIT

Në 20 gusht 2010 në komunën Velçan, nga administrata e kësaj komune u organizua një takim brezash, në mjediset e pyjeve të bukura, afër rrugës automobilistike. Në këtë takim morën pjesë kryetari i komunës Velçan, Ilir Mani, administrata e komunës Velçan, të ftuar ishin kryetari i komunës Proptisht, Shaban Sula, sekretari i komunës, Përparim Isufi, Zini Bufi. Nga Velçani ishte kryeplaku E'them Rrapçe, I Buzaishtës Pëllumb Hyko, ish kryetrai kimunës Velçan Ramazan Rrapçe e tjerë. Ishin shumë banorë, të fshatit po

KRIJOHET DEGA E SHOQATËS "PELIONI,, NË KOMBINAT

Më datën 5 gusht 2010 në një nga lokalet e qendrës në Tiranë u bë një takim me disa nismëtarë mokrarë të cilët kishin kohë që mendonin se duhet të krijonin një degë të shoqatës "Pelioni" në zonën e Kombinatit. Në takim ishin nënkryetari shoqatës "Pelioni,, zoti Zabit CUKU dhe sekretari zoti Zenun FERRO. Zoti Aris Durbaku një nga inisiatorët e krijimit të kësaj dege informoi lidhur me aktivitetet dhe problemet e deritanishme duke shprehur dëshirën dhe mendimin në emër të nismëtarëve për të krjuar degën e kësaj shoqate në Kombinat.

Këta nismëtarë të Kombinatit kanë disa kohë që bëjnë takime dhe biseda me mokrarë dhe dashamirës. Në këtë zone deri tani janë afëruar dhe shprehur dëshirën për të krijuar degën e shoqatës, Aris Durbaku, nga Rodokali, Bujar Qyrku nga Velçani, Hasan Çela, nga Velçani, Fatmir Qyrku, nga Velçani, Ismail Qyrku, nga Velçani, Ylli Biba, nga Velçani, Skënder Mertkolla, e Xhevair Rustemi nga Rodokali, Enver Gjera, nga Bishnica, Avni Kurti, nga Straniku, Ramis Mokrari, nga Senishti, Gezim Sherri, nga Losniku, Thoma Balliu, nga Slabinja, Petrit Gjata nga Homeshi, Eqerem Durbaku e tjerë.

Më tej zoti Aris theksoi se vazhdimisht ne realizojmë takime dhe vizita të ndryshme tek njëri tjetri lidhur me rastet e krijuara nga secili. Këtu bisedojmë dhe kërkujmë tek njëri tjetri që të mbajmë nderur traditat, zakonet dhe të ngremë sa më lart figurën e Mokrës dhe të çdo mokrari kudo që jeton dhe punon. Për çdo muaj presim dhe marrim e përhapim materialet që propogandon gazeta "Mokra". Gjatë këtij muaj mendojmë që të bëjmë edhe zgjedhjet e degës duke ftuar që të marrin pjesë nga kryesia e Shoqatës. Me këtë rast si takimi i parë Arizi ben thirje të gjithë mokrarëve se kudo që janë të takohen, të mbidhen dhe të këndojnë e mos harrojnë po të ngrenë dollinë dhe dashurinë mokrarë.

Zabit CUKU, N/kryetari i shoqatës

2010. Të bëhet një program i veçantë për një takim në Selcën e Poshtme, "Pelion,, gjatë vitit 2011. Të mblidhen dhe evidentohen sipas zonave këngët e krahinës Mokrës, studimit të historisë së Gurit të Kamjes, para 100 vjetorit të pavarësisë në vitin 2012. Shumë diskutantë si Bujar Balliu, Nesti Maçolli, Koço Pihoni piktori Lame ishin për të rritur më shumë punën e secili të japë më shumë për shoqatën "Pelioni,,. Diskutimet u mbyllën nga sekretari shoqatës zoti Zenun Fero, i cili shtoi disa detyra se nuk duhet të ketë pritje por secili të gjejë vërtetë në profesionin që ka dhe të organizojë, të bëjë takime, pra pak e pak dhe bëhet shumë punë. Jo pritje për takime, e studime por secili të shohë veten duke punuar dhe bërë diçka për të ardhmen të

cilat tu ngelen brezave njëri pas tjetrit.

Po të kishim pritje nga të tjerët nuk do të ishte krjuar shoqata "Pelioni,, nuk do të kishte dale dhe botuar gazeta "Mokra,, që nga 25 marsi i vitit 1999, të cilët janë bërë mbi 138 numura gazette. Nuk do të ishim takuar dhe biseduar asnjë ditë dhe as sot këtu me juve të nderuar mokrarë.

Shoqata kërkon të hapet një horizont më i gjërë, kushte për punë, të bën të punosh më shumë me njerëzit, e tjerë të rinj dhe të moshuar. Me këtë rast ju uroi më shumë suksese duke punuar dhe patur plotësisht besim tek puna që bëni ju dhe gjithë mokrarët urime.

Zenun FERRO,
Sekretari i shoqatës "Pelioni,,



edhe shumë emigrantë, dhe ky takim për këta bëhej që të takoheshin. Bisedimet ishin të ngrohta, dhe shumë miqsore, këto takime duhen, na afrojnë, na çmallin, t'i bëjmë siç i bëjnë të gjitha komunitet e kulturuar.

Në Mokër kjo traditë është future e re, por duhet te fuqizohet më shumë dhe më shpesh me takime e biseda. Emigranti Artan Çela theksoi se kumna duhet të bëjë më shumë për raste të tilla me takime biseda, koncerte apo aktivitete të tjera. Në vimë një herë në vit dhe nuk duhet të shpëputemi nga njëri tjetri, nga vendlindja e jonë.

Duhet të përmendet punë e mirë e guximshme e Nexhmi Mena. Ledi Mysliut, avdulla hyka, Bedri Mokrari për një guzhinë tradicionale dhe me kulturë.

Kjo është festive dhe shumë e bukur, dhe propozojmë që të bëhet për çdo vit, kushtet janë. Komuna e Proptishtit ka ku ta bëjë, në Selcën e Poshtme. Mendoj që të bëhet në maji të vitit 2011, në kushte pranvere. Të rregullojmë infrastrukturën në Selcën e Poshtme, Pelionin e Lashtë. Të përgatisim edhe takim brezash nga historia e Pelionit.

Përparim ISUFI

AUTORI BARDHYL BERBERI KA NXJERRË ROMANIN MË TË FUNDIT "NJË NATË NË ÇIKAGO,, NJË PRIURJE E RËNDËSISHME NË PROZËN SHQIPTARE

Shkrimtari Brdhyll Berberi, vjen me romanin e fundit "Një natë në Çikago,, vjen pas suksesit të autorit me librin me novela "Tranzicion,, romaneve "Vrasja e Shpirtit,, "Burgun e Selanikut,, "Vrasje në Shën Valentin,, fitues i çmimit "Mitrush Kuteli,, në vitin 2008, "Lule të vyshkura në prill. Romani "Një natë në Çikago,, është botuar në disa shtëpi botuese me emër në Francë, Angli, Gjermani dhe Austri, tregon se autori pogradecar është një prurje e rëndësishme në prozën shqiptare.

Romani është një dramë e shoqërisë shqiptare, e një familje shqiptare, e cila udhëton me familjen e saj drejt SHBA-së, pasi i ka dalë llotua amerikane. Personazhi kryesor është gjykatësja Monda Marina, një grua sa pasionante po aq edhe misterioze, që llogaritë e saj i bën në mënyrë të çrregullt, ndërsa bashkëshorti i saj Luani është më i rregullt, për një jetë me bazë në tokë. Ata nuk e përballojnë jetën në SHBA, dhe secili vazhdon jetën e tij.

Është një rastësi në Çikago, pasi gati 10 vjet shkëputje nga ish bashkëshorti i saj, ajo në SHBA, dhe Luani në Shqipëri, është vërtet një gjyq i ri që i bëhet marrëdhënies së tyre. Alternativa se të humbësh një dashuri, në këtë jetë nuk është e lehtë, me këtë mundohet të justifikojë jetën Monda Marina, që të dalë nga jeta e vërtetë, Ndërsa Luani, ish burri i saj një inxhinier i përkushtuar ka punuar dhe nuk del nga kornizat. Ai është personazh me jetë të mirë organizuar, dhe është befasuar nga pabesitë e gruas së tij, si nga veprimet korruptive në gjykatë, po edhe nga korrupsioni shqiptar dhe tradhëtia e saj bashkëshortore. Në roman del se Luani është i kundërt i gruas, i cili gjithçka e arrin në rrugë të nderëshme dhe me djersën e ballit. Personazhi Luan, si një intelektual me këmbë në tokë, që nuk habitet nga mrekullia amerikane, por emocionet i mban nën fre, në çdo hap që hedh, i vjen pranë në çdo rast Shqipëria.

Ky roman është një filtër, që kthello mendjet e gjithë kujt që ëndërron për në SHBA, që e ndërgjegjëson për sfidat që e presin. Secili duhet të jetë i gatshëm që për të mbrojtur ëndërrat duhet të njohë edhe gjërat e tjera të këqija.

Autori ka përshkruar në realizëm gjithçka në Çikago në disa vende të tjera të SHBA, në Evropë. Romani është me vlera edukative, me vlera psikologjike.

Autori tenton të futet në kështjellën ku fshihet origjina e gabimit, të familjes Mara, rrugët e zgjidhjes e tjera.

Frymëzimi poetik i autorit Bardhyll Berberi në këtë moshë të pjekur, kapërcehet është një frymëzim i vërtetë, i ngjan verës së vjetër që ka një shije të veçantë të pashoqe.

Kalimi i shkrimtarit nga poezia në prozë quhet për shkrimtarët që hedhin ato hapa nga një kalim nga rinia e pjekur. Ky libër duhet lexuar, është libër i mirë. Jeta është e shkurtër, koha dhe fuqitë janë të kufizuara. Ky roman ruan kujtesën në letër. Në fund lë të kuptojnë se kurrë gjatë shekujve një mjet i ri, nuk e ka zëvendësuar plotësisht të më parshmen. As vareja nuk e ka zëvendësuar çekanin. Fotografia nuk ka dënuar me vdekje pikturën, e kinemaja nuk e ka vrarë fotografinë, televizioni nuk e ka eliminuar kinemanë, treni bashkëjeton mirë me veturën dhe aeroplanin. Përkthimi i këtij romani duke u botuar në disa shtëpi botuese me emër në Francë, Angli, Gjermani, dhe Austri tregon se ky ka vlera të mëdha, është një prurje e rëndësishme në prozën shqiptare. Urime shkrimtarit Bardhyll Berberi, me botime të tjera më rëndësishme, më të mira.

Zenun FERRO

SHUHET ZYFER LEKA, ISH-KRYETARI KOOPERATIVËS SË PROPTISHTIT E VËRRIT

Një nga njerëzit e veçantë, drejtuesit e zotë të mokrës, ish-kryetari i kooperativës së Proptishtit e Vërritit, Zyfer Leka, u nda nga jeta në moshën 88-vjeçare. Familjarët, miqtë, shokët e përcollën për në banesën e fundin në mesin e muajt shtator. Ai ishte drejtuesi që mori falënderime dhe urimet për punën me ndershmëri dhe dashurinë për bashkëfshatarët e tij. U lind në Proptisht në 19 qershor 1922. Në 1957 mori drejtimin e kooperativës bujqësore të Proptishtit dhe më pas atë të Vërritit. Gjatë gjithë jetës së tij si kryetar shërbeu me pasion e dashuri, duke lënë pas gjurmë dhe emrin e tij të mirë tek të gjithë ata që patën fatin të jetojnë e punojnë me të. Në vitin 1982 doli në pension. Pas vitit 1991 u shpërngul familjarisht në Pogradec, aty ku jetoi afro 20 vjet, derisa mbylli sytë më shtator 2010. Ngushëllime të sinqerta familjes dhe njerëzve të tij të dashur. Xha Zyferin do ta kujtojnë jo vetëm të dashurit e familjarët e tij por të gjithë ata që i donte dhe e donin me gjithë zemër. Mirënjohje e respekt për Zyfer Lekën!

Ndërtimi i hidrocentraleve në Mokër

Nga Zenun FERRO

BILACI I MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERJITIKËS

Në bilancin e bërë nga ministria e Ekomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës më 16 gusht 2010, lidhur me ecurinë e konkencioneve të hidrocentraleve, theksohet se janë mbi 20 hidrocentrale, të cilët janë në punë e sipër, duke u ndërtuar. Disa prej tyre kanë filluar prodhimin dhe deri në fund të vitit 2010, do të jenë rreth 12 hidrocentrale që do të kenë përfunduar e do të vihen në punë në prodhim të energjisë.

Në këtë kuadër nga ministria e Ekonomisë u bëhet thirrje investitorëve që të orientohen drejt sektorit energjistik dhe potencialeve të medha që afron në këtë aspekt vendi ynë, duke shtuar garancinë për shitjen e energjisë e jep vetë qeveria shqiptare. Është e garantuar me ligj nga qeveria shqiptare me një çmim, i cili është i leverdisshëm. Ministria e Ekonomisë fton kompanitë e huaja dhe ato shqiptare të bëhen pjesë e programeve të veçanta të Bashkimit Evropian për investime në fushta e prodhimin të energjisë të rinovueshme, nga era, ujë e nga dielli, të cilët janë inensifikuar në vijim. Deri tani janë trajtuar 51 kërkesa për hidrocentrale të reja dhe 8 kërkesa për parqe të prodhimin të energjisë nga era. Nga 51 kërkesa për ndërtime hidrocentralesh, hidroteknike dhe 32 të tjera janë në fazën e tenderimit dhe të negociimit të kontraktoreve.

KONCENSIONI MBI LUMIN SHKUMBIN ËSHTË I BAZUAR NË LIGJ.

Me projektin e HEC-cit mbi lumin Shkumbin, është zbatuar e gjithë procedura ligjore që dikton ligji. Firma e ndërtimit për ndërtimin e hidrocentraleve mbi lumin Shkumbin është regjistruar më 11 prill 2008 me përfaqësues Kristo Stefan Radi. Shoqëria "LNK shpk., me administrator Naim Luan Kurti, me qendër në Tiranë ka bërë praktikën e ndërtimit, të gjitha studimet, teknike, e mjedisore, dhe ka aftësi teknike për ndërtimin sipas standardeve ndërkombëtare.

Firma "Hidro-Poëer-Elektrik, përbëhet nga investitorë privatë shqiptarë dhe do të bëjnë ndërtimin e hidrocentralit të Slabinjës, Bishnicës Nr. 2. Investitorë janë vëllezërit Kurti, dhe Enkelejt Kurti të cilët



Nga ndërtimi i hidrocentralit te Slabinjës

kanë theksuar se do të investojnë 10 milion Euro, vetëm vlera e për infrastrukturën, makinerinë, e pajisjen do të shkojë 1 milion Euro.

Hidrocentrali i Slabinjës, nga të dhënat e marra nga interneti ka këto të dhëna, gjatësia nga burimi deri në digë 8.5 km, fuqia 9.3 megavat, fuqia 50 milion kë/orë në vit, ka kosto financiare 10 milion Euro. Do të përmissojë furnizimin me energji komunat Velçan, Proptisht, dhe do të lidhet me rrjetin kombëtar. Është projekti i parë mbi lumin Shkumbin. Disa dhjetra kompani shqiptare kanë marrë inisiativën për të investuar në sektorin hidroenergjitik shqiptar. Konkensionet për ndërtimin e hidrocentraleve janë tërësisht private, ku investitorit merr rrishtin e projektimit, ndërtimit, riparimit, rinovimit të teknologjisë si dhe të transferimit tek shteti brenda 35 vjetëve. Konkensionet është i llojit "BOT", për një periudhë kohore 35 vjetecare.

HIDROCENTRALI BISHNICA-2

Në teritorin e Bishnicës ishte menduar të bëhen dy hidrocentrale të vegjël, Bishnica Nr.1 e Nr. 2. Nga dokumentat e bëra del se Bishnica Nr.1 nuk i plotëson standartet mjedisore, të komunitetit civil, i merret uji i pijshëm, dhe për këto nuk u miratua për ndërtim.

Bishnica Nr. 2 u miratua për ndërtim, dhe fillon punimet nga firmat fituese, dhe më 18 korrik 2010, siç thekson sekretari i komunës Proptisht Përparim Isufi, u bë prova e parë dhe doli me sukses

Është shtrirë linja elektrike e shpërndarjes së energjisë elektrike nga fshati Losnik, deri në fshatin Slabinjë, deri më 20 gusht 2010. Ndërtimi i linjës ka vazhduar nga Qukësi, Proptisht dhe deri në Slabinjë, nga një firmë nga Ohri, ndërsa sheshet e ndërtimit, dhe betonet bëhen nga një firmë shqiptare, me përfaqësues Çelik Feron. Firma maqedonase kishte shtyllat metalike me të gjitha mjetet e saj, hekurat, mekanikën, pajisjet, motorrat ngritës dhe fuqinë puntore të saj.

HIDROCENTRALI I SLABINJËS

Ka filluar që në vitin 2008 hapja e trasës së kanalit të hidrocentralit që nga fshati Losnik, deri tek ura e Tereziut, Slabinjë, me gjatësi 8.5 km dhe gjerësi 6 metra, nga kjo 2.4 metra për gjerësinë e kanalit të ujit, dhe pjesa tjetër rrugë për makinat, për të kontrolluar kanalën e hidrocentralit, gjatë ndërtimit dhe gjatë shfrytëzimit. Kanali ka përmasa të ndryshme, nga Losniku e deri tek Lëmi i Çelës ka një gjësi 2.2 metra dhe thellësi 2.1

metra dhe pas kësaj deri tek sheshi i digës ka përmasa gjerësi 2.4 metra, trashësia 20 cm dhe një thellësi 2.1 metra. Kjo bëhet sepse tek Lëmi i Çelës, do të sillet me tubacion uji i lumit të Çezmës, Trebinjës. Diga e hidrocentralit në Losnik do të ketë tre tunele, dhe në fund do të ketë një shesh i madh, për ujin që vjen në përmasa 40x50 metra. Diga e lëshimit do të jenë dy, në një lartësi mbi 291 metrash. Vendi i sheshit të hidrocentralit, po ndërtohej gjatë muajt gusht 2010, dhe kanali i tubave të digave ishte ndërtuar.

Në gusht 2010, gjithë personeli inxhinero teknik e ndërtues ishte tek diga, se po behesh bentonimi i saj, e ndiqnin me kujdes të madh, kjo ngrihesh nga dita në ditë. Po punohesh për ndërtimin e tunelit të Losnikut ku do të dali uji dhe të shkojë tek diga e hidrocentralit.

Personeli tjetër është në ndërtimin e kanalit të hidrocentralit. Ishin pesë brigada për ndërtimin e kanalit, me përgjegjës zotin Krenar, tre brigada janë nga rrethi i Librazhdit, një nga Slabinja dhe një nga Pogradeci, inxhinieri i punimeve është zoti Jetnor Kurti. Fabrika e prodhimin të betonit është ndërtuar tek ura e Slabinjës, e nje teknologjie të përparuar, me një organizim sipas rregullave dhe stanadarteve nga më të përparuarat. Mjetet e renda bëjnë transportin e betonit për betonimin e digës dhe të kanalit në çdo kohë dhe sipas rregullave. Fabrika e betonit ishte siguruar dhe ruhesh nga roja Hysni Balliu nga fshati Slabinjë, më parë ruhesh nga Kujtim Balliu po nga ky fshat.

Firma ndërtuese, kishte marrë masa të plota, për sigurimin e kushteve të jetsës dhe të ushqimit, në fshatin Slabinjë, ishte ngritur një kuzhine e vogël me guzhiner Shaqir Sinani, i cili gatuaente ushqimin falas, për shoferat e kompanisë. Kishin marrë një shtëpi me qera, ndërsa personeli inxhinero teknik ishte vendosur në qendër të komunës Proptisht.

HIDROCENTRALI I STRANIKUT

Hidrocentrali i Stranikut po ndërtohet mbi lumen e Stravajit, punimet kanë filluar, por për disa arsye objektive në vitin 2009 u ndërpre. Në vitin 2010 ato kanë filluar dhe vazhdojnë rregullisht.

HIDROCENTRALI I NIÇËS

Ka filluar ndërtimi i tij, por nuk kemi siguruar të dhëna, për këtë ta falin lexuesit, por do t'i informojm një herë tjetër.

Krishterimi në zonën e Mokrës

NË ILIRIKUM APO SHQIPËRI, KRISHTËRIMI NJIHET QYSH NË SHËKULLIN E PARË TË ERËS SË RE

Nga Llazi TONA

Krishterimi është një fe e themeluar mbi mësimet, mbi personin dhe jetën e Jezu Krishtit. Bashkësia e parë e krishtere që besonte në Nazaretin dhe mësimet e Jezu Krishtit të Nazaretit, si profet i ri, lindi në pjesën lindore të Perandorisë Romake, në Jeruzalemin e Izraelit. Kisha e krishterë u përkrah në gjithë qytetet e tjera të Palestinës, në Romë dhe në të gjitha vendet e tjera të Perandorisë Romake. Në ILIRIKUM krishterim njihet kryesisht qysh në shekullin e parë të Erës së Re. Qysh atëherë Durakumi, Apollonia, Nikopoja, Lisus, Shkodra, ishin qendra bregdetare prej nga krishterimi u përhap në thellësi nëpër provinca si: Epiri i Veriut, Epiri i Jugut, Dardani e Maqedonia, etj. Nëpër qytete, kastele, krahina u ngritën kishat e para krishtere.

Me ndarjen e Perandorisë Romane, në dy pjesë të lindjes dhe perëndimit, pjesa më e madhe e Shqipërisë kalon në anën e

lindjes. Në gjysmën e dytë të Shekullit të VIII-të krishterimit ortodoks përfshin pjesën dërrmuese të popullit në të gjithë Shqipërinë dhe varej nga Patriarkana e Kostandinopojës. Në Shek X krijohet Peshkopata e Ohrit në varësi të saj kaloi dhe Peshkopata e Shqipërisë.

Me ndarjen zyrtare të krishterimit (1054) territoret shqiptare u ndanë midis dy qendrave të mëdha të botës së krishterë, Kisha Katolike Perëndimore me qendër në Romë, dhe Kisha Ortodokse Lindore me qendër në Kostandinopojë. Pjesa më e madhe e të krishterëve shqiptarë vazhdon të qëndrojnë e lidhur me Patriarkanën e Konstandinopojës, por në skajin veriperëndimore u kristalizua një enklavë katolike me peshkopatët e Tivarit, Ulqinit, Drishtit, e Shkodrës, që njohën autoritetin e Papës së Romës. Në mesjetë, në Shqipëri, krijohet një vark institucione të tjera. Më 1691, në Lllungë (Llëngë), në pozicionin që ndan Mokrën me Gorën, u ndërtua Metropolia apo Katedralja e Shën

Marisë me emërtimin "Metropolia Mokër-Gorë" me qendër në Llëngë mbi bazën e planimetrisë së Patriarkanës së Ohrit. Pikturimi i Ikonostasis dhe afreskeve murore u bë nga piktori i madh Kostandin Jeromaesku. Nga disa akte sinoide që gjenden në një kodik të vjetër të Kryepeshkopatës së Ohrit, del se Metropolia Mokër-Gore me qendër në Llëngë ka pasur këta episcopë: Arseni në vitin 1691 - 1705; Serefini më 1752 -1762; Theodhosi më 1719; Mihali më 1742; Areoni më 1763.

Nga fundi i shekullit 18-të katedralja kalon në varësi të Metropolisë së Durrësit dhe merr titullin "Metropolia e Durrësit dhe Mokër-Gore" që përfshinë Tiranën, Kavajën, Elbasanin dhe Pogradecin.

Metropoli të tilla u ngritën në Voskopojë, Vithkuq, Gramostea, Olimp, Pindi, Suli, Veria, Follorinë, Vlanodisera, Moluniste, Krushevea, Ternera, Makarava, Kosturi, Prespa, etj. Krahina e Mokrës - sipas Barletit - ishte një vend shumë i bukur, me shumë katunde të dendura, me popullsi. Ata ishin të krishterë.

Me pushtimin otoman dhe përhapjen e islamizmit, krishterimi pësoi goditje të

rëndë dhe ngeli shumë mbrapa vendeve të tjera evropiane, si në ekonomi, kulturë, arsim etj. Krahina e Mokrës i rezistoi shumë pushtimit otoman dhe islamizimit të saj. Në bazë të të dhënave të marra nga defterët e Turkut, Mokra më 1519 dhe 1580 ishte e krishterë (shih tabelën e poshtme). Në shek 18-të dhe 19-të në Shqipëri ishin islamizuar dy të tretat e popullsisë po kështu edhe krahina e Mokrës:

Defterët turq të vitit 1519 mbi familjet kristiane:

Velçani	83 familje
Goliku	26
Dunica	85
Zemça	12
Katjeli i madh	100
Katjeli i vogël	30
Kriçkova	16
Quksi	90
Lakteshi	38
Losniku	15
Malina	18
Pleshishti	63
Rajca	68
Selce e siperme	37
Selce e pasohme	22
Slabinja	86
Slatina	19
Stravaj	17
Çezma e madhe	61
Çezma e vogël	34 etj.

Bajram Rika, mjeku i parë stomatolog në Mokër

Nga Sami LEKA


Brezi i viteve 70-80-të e mban mend shumë mirë dentistin me durat të arta Bajram Rika. Sa e sa dhimbje ka shëruar, sa e sa gojë ka zbukuruar, sa e sa njerëz ka takuar e njohur në Mokër. Ai ishte bir i saj dhe i shërbeu asaj për vite me radhë. Bajrami ishte stomatologu i parë i Mokrës, mjeku i palodhur i zonës, nga ata mjekë që nuk harrohen kollaj sepse në radhë të parë ishin njerëz humanë, pastaj mjekë.

Bajrami u lind në Bishnicë, në Shpella të rrethit të Pogradecit, më 30 tetor 1946. Rrjedh nga një familje e varfër fshatare me tradita atdhetare, njerëz të ndershëm e punëtorë. Familjarisht përkrahu Luftën, por xhaxhai i tij, Riza Rika, ka marrë pjesë në radhët e partizanëve gjatë Luftës.

Nëna e Bajramit, Selvika, u nda nga jeta kur Bajrami ishte 6 vjeç. Vëllezërit e tjerë ishin në moshën 10 vjeç. Atit të Bajramit, Nezirit, iu desh që të rrisë 4 fëmijë të vegjël me vaujte dhe halle të mëdha. Nga njëra anë të siguronte ushqimin dhe veshmbathjen për të rritur fëmijët, por më i rëndësishëm ishte shkollimi i tyre. Dhe këtë Neziri mendohej ta

arrinte me shumë sakrificë. Mësimet e para Bajrami i mbaroi në fshatin e lindjes. Në shkollë shquhej si nxënës i rregullt dhe i shkathët në mësimet. Shkollën e mesme "Muharrem Çollaku" e mbaroi në Pogradec me rezultate shumë të mira. Si nxënës aktiv dhe me prirje shkencore i jepet drejta e studimit për degën e stomatologjisë në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Në qershor të vitit 1973 diplomohet mjek stomatolog. Mbas mbarimit të shkollës së lartë, emërohet me punë në qytetin e Pogradecit gjatë viteve 1973 - 1974. Aty, Z. Bajram, tregon aftësitë e tij profesionale në shërbim të popullit: i qetë, i aftë në pritjen e përcjelljen e klientëve.

Në vitin 1975 transferohet në Mokër ku punon për 15 vjet në klinikën dentare të Proptishtit. Pas kësaj kohe, që nga viti 1987 e deri në vitin 1994 punoi në klinikën dentare në Beragozhdi të rrethit të Pogradecit. Më vonë në Buçimas, në Pogradec dhe sot aktualisht në qytetin e Pogradecit. Puna e tij shquhet dhe vlerësohet nga njerëzit që kuron dhe u shërben në mënyrë shkencore. Punimet e tij janë me jetëgjatësi; Arif Alla, Nexhmi Leka, nga Verriri, Agron Leka nga Proptishti, Ruzhdi



Frahollit nga Beragozhdi etj. thonë se mjeku stomatolog Bajrami ka sa vlera profesionale, aq edhe humane. Ka mbi 25 vjet që ka bërë punime në gojën tonë dhe s'kemi asnjë defekt. Ai

në çdo kohë është i përkushtuar dhe shërben në mënyrë profesionale, pa shkaktuar anomalitë në profesionin e tij. Kudo ku ka shërbyer z. Bajram Rika është karakterizuar për devotsh-

mëri të lartë në punë. Mokra e mokrarët ruajnë kujtimet më të mirë për këtë mjek të përgatitur në krahinë.

Për punë të mirë z. Bajram Rika është dekoruar me urdhrin e "Mjekut". Mban edhe shumë dekorata të tjera për punë të mirë shkencore në profesionin e stomatologut.

Ka marrë pjesë në sesione shkencore brenda dhe jashtë vendit në qytetin e Shkupit, Strugës të Maqedonisë. Bajram Rika është edhe një njohës i mirë i gjuhëve të huaja, veçanërisht një mirë gjuhën angleze.

Në vitin 1980 Bajrami krijon familjen e tij. Martohet me Znj. Elisaveta Çekiçi me profesionin ndihmës-mjeko. Aktualisht Elisaveta punon si kryeinfermiere në Buçimas. Shquhet për punë të mirë. Nga kjo martesë kanë lindur dy fëmijë të mrekullueshëm, Geralda dhe Jetmiri. Geralda është martuar dhe vazhdon studimet në Belgjikë për gjuhën frënge dhe Jetmiri vazhdon studimet në Universitetin "UFO" në Tiranë, dega stomatologji, viti i tretë.

Specialistë si Bajram Rika janë një thesar i paçmuar për Mokrën, që kanë punuar dhe punojnë me ndërgjegje të lartë. Duke përfunduar, i urojmë Z. Bajram dhe familjes së tij, shëndet dhe suksese në punë e në jetë.

Nga jeta në SHBA e mokrarit Fahri Toska

„SHBA-ËSHTË NJË EMËR I MËDH, POR VETEM ME PUNË ESHTË BËRË E TILLË“

Ishte 14 gushti 2010, në një takim me kolegët në Tiranë, Shqipëri, tregon jetën e tij të re në SHBA. Në 10 shkurt të vitit 2008, duke më dalë llotaria amerikane u nisa me familjen drejt SHBA, në Brooklyn NY. Natyrisht ndarja me prindërit nuk ishte e thjeshtë po shumë e vështirë, ne po shkonim, por a' do të takoheshim më, por ja që koha kaloi me të mirat dhe të këqiat dhe më 23 korrik 2010, pas dy vjetësh kthehet në Shqipëri, Pogradec. Ai në këtë takim tregon:

Nisja drejt SHBA, ishte e vështirë, me shumë dokumenta për të vërtetuar identitetin tonë, në çdo drejtim, shëndetësor, arsimor, financiar e tjerë. Pritja na u bë nga Rovena Aliaj, mbesa e gruas, ishte një pritje shumë, e mirë dhe e i falenderit shumë. Këtë e bëjnë vetëm njerëzit me zemër të madhe, pra ashtu është edhe Rovena. Nga fshati Selcë e Sipërme, Pogradec është Besnik Toska, Behar Tosak, Luan Ademi, më shumë këtu ka nga Pogradeci, Korçarë e tjerë. Pas sistemimit të plotë u interesuam për punë, duke mos pranuar ndihmë sociale. Pas tre muajsh fillova punë, për të siguruar të ardhura për familjen. Natyrisht duhej të përballonim shtëpinë me qera, konsumin e përditshëm dhe shpenzime të tjera.

SHBA ka një emër të madh, por atje ka vetëm punë.

Vajzat e mia, Adriana, dhe Eri u përshtatën shumë shpejt, dhe janë dalluar



në shkollat amerikane. Adriana, në klasën e tetë, e mbaroi vitin mësimor me medalje ari, dhe tani vazhdon shkollën e mesme të përgjithshme, është shumë mire me mësimet. Edhe vajza tjetër Eri, është shumë mirë me mësimet. Arsimit amerikan e lehtëson shkollimin e fëmijëve, librat shkollorë jepen falas, kanë shërbime në shkollë, deri ushqimin për një vakt.

Shërbimi shëndetësor, paguhet sipas të ardhurave që ka çdo familje, po nuk pate të ardhura, të jepet ndihmë shëndetësore. Nga mjeksia ka kontrollë periodike, ku të thërret vetë mjeku në çdo gjashtë muaj. Për fëmijët ka një kontroll të vazhdueshëm dhe bëjnë vaksi-

nat rregullisht.

Në SHBA nuk ka dallim për punën, për çdo punë do të testohesh dhe po e more testin fillon punën menjëherë. Por nga kompania, kërkohet të kesh një person që të njeh, të kesh siguri. Kriza në vitin 2009-2010, bëri punën e saj, u shkurtuan shuëm vende pune, por na u dha asistencë e mjaftueshme.

Shkolla amerikane, ka një disiplinë për procesin mesimor. Orari i shkollës fillon ora 8.00 e përfundon 16.30, me të gjitha disiplinat. Në orën 8.00 shkojnë nxënësit që kanë nevojë për konsultime, mësim gjuhe, ndërsa mësimi fillon ora 8.45. Mësuesi ka një bashkëpunim me prindrit, në çdo muaj ka takime me prin-

drit. Nxënësve të shkollës së mesme në çdo tre muaj u behen teste, ata më të mirët i bashkojnë në një klasë, pra nxënësit përzgjidhen, klasifikohen. Lëndët bazë që testohen janë matematika dhe gjuha, po more këto o merr testet.

Çdo shqiptar me llotari amerikane, për pesë vitet e para është më kartë gri dhe kur mbush këto bën aplikimin. Për këtë testohet, në gjuhë dhe histori. Na japin 100 pyetje që duhen mësuar, nga këto ka pyetje për njohjen e historisë së SHBA. Testimi jepet 1-2 herë, deri sa të merret.

Deri sa të pajisesh me pashaportë, është pak e vështirë për punë. Punët që mund të punohet është sektori i ndërtimit, rrobaqepsitë, shërbime në lokale tregtie, siguria në objekte të tjera etjera.

Për fëmijët ka ligje të veçanta, nuk u lejohet të pijnë duhan, pije alkoolike, nën moshën 21 vjeçe. Nuk kanë të drejtë të blejnë në dyqane, për këtë shitësit u kërkojnë dokumenta identifikimi për moshën. Kryesore është patenta e drejtimit të automjetit e cila perdoret për identifikim dhe kudo që shihet e nevojshme.

Vlerëson rregullin, zbatimin e plotë të ligjit, dhe atë humanizmin njerëzor. Është shumë i kënaqur deri tani me familjen e tij në SHBA.

Bisedoi në Tiranë:
Zenun FERRO, Zabit CUKU

